

**IMUNOTERAPIA SPECIFIKE NE
TRAJTIMIN E ALERGJIVE RESPIRATORE**

MIRELA HITAJ

SHKURT, 2016

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI MJEKESOR I TIRANËS

DISERTACION

I
PARAQITUR NGA

ZNJ. MIRELA HITAJ

PËR MARRJEN E GRADËS SHKENCORE

“D O K T O R”

SPECIALITETI: MJEKESI E PERGJITHSHME

TEMA: *IMUNOTERAPIA SPECIFIKE NE TRAJTIMIN E ALERGJIVE
RESPIRATORE*

MBROHET MË DATË ____ / ____ PARA JURISË

- 1.Prof.As.Gentiana Qirjako _____ KRYETAR
- 2.Prof.As.Edmond Pistulli _____ ANËTAR (OPONENT)
- 3.Prof.Elizana Petrela _____ ANËTAR (OPONENT)
- 4.Prof.As.Kiri Zallari _____ ANËTAR
- 5.Prof.Ëtleva Qirko _____ ANËTAR

UDHËHEQËS SHKENCOR
PROF. Dr. Tatjana Cina

Kushtuar familjes time!

Pasqyra e Lendes

	Faqja
Lista e Shkurtimeve	6
Lista e Figurave	7
Permbledhje	9
Summary	10
1 Hyrje	11
1.1 Semundjet Respiratore IgE-vartese	11
1.1.1 Riniti dhe Konjuktiviti Alergjik	11
1.1.2 Astma Bronkiale	13
1.2 Pergjigja IgE-vartese dhe Patologjite Respiratore	13
1.3 Diagnoza e Patologjive Respiratore Alergjike IgE-vartese	14
1.4 Trajtimi i Patologjive Respiratore IgE-vartese	15
1.5 Mekanizmi i Veprimit te ITS	16
1.6 Ekstraktet e Alergeneve, Cilesite dhe Perdorimi	19
1.6.1 Cilesite e Alergeneve te ITS	19
1.6.2 Menyra e Perdorimit te Alergeneve te ITS	22
1.6.3 Rruget e Administrimit dhe Teknika e Injektimit Subkutan	22
1.7 Qellimi i Studimit	23
2 Materiali dhe Metoda	25
2.1 Diagnostikimi dhe Perfshirja/Perjashtimi i Pacienteve	25
2.2 Pergatitja dhe Plotesimi i Pytesorit te Monitorimit Klinik dhe Terapeutik	25
2.3 Analiza Statistikore e te Dhenave	26
3 Rezultatet	27
3.1 Te Dhena te Pergjithshme	27
3.2 Simptomatologjia Klinike para ITS	27
3.3 Terapia Farmakologjike para ITS	27
3.4 Ecuria e Simptomatologjise Klinike dhe Nevojave Medikamentoze gjate ITS	28
3.4.1 Pacientet me Konjuktivit Alergjik	28
3.4.2 Pacientet me Rinit Alergjik	28

	Faqja
3.4.3 Pacientet me Astme bronkiale	29
3.4.4 Pacientet e Trajtuar me Extrakte Akarienesh	30
3.4.5 Pacientet e Trajtuar me Ekstrakte Polenesh	30
4 Diskutim	64
4.1 Efekti i ITS mbi Pikezimin Klinik	64
4.2 Efekti i ITS mbi Konsumin e Medikamenteve	65
4.3 Rezultatet Tona dhe te Dhenat e Literatures	66
4.4 Perfundime	67
5 Bibliografia	69
6 Curriculum Vitae	74
7 Lista e Punimeve	75
7.1 Botime te Lidhura me Temen e Disertacionit	75
7.2 Prezantime te Lidhura me Temen e Disertacionit	75
7.3 Botime te Tjera	75
7.4 Prezantime te Tjera	76
8 Falenderime	78
9 Deklarate	79

Lista e Shkurtimeve

AB	Astma Bronkiale
Bregs	Qeliza Rregullatore B
CD	Cluster of Differentiation
IFN	Interferon
Ig	Imunoglobulina
IL	Interleukina
ITS	Imunoterapia Specifike
KA	Konjktiviti Alergjik
NGF	Nerve Growth Factor
PK	Pikezimi Klinik
RA	Riniti Alergjik
SE	Gabimi Standart (Standart Error)
TGF	Transforming Growth Factor
Tregs	Qeliza Rregullatore T

Lista e Figurave

	Faqja
Figura 1: Prevalenca e wheezing dhe hiperreaktivitetit bronkial gjate viteve 90	12
Figura 2: Mekanizmat e tolerances se alergenit	18
Figura 3: Ekstrakt alergjenik i standartizuar per perdorim subkutan	20
Figura 4: Alergenet me permbajtje proteazash	21
Figura 5: Miksturat alergjenike te parekomanduara si pasoje e pranise se proteazave	21
Figura 6: Teknika e injektimit subkutan te alergenit gjate trajtimit me SCIT	23
Figura 7: Ecuria e intesitetit te pruritit okular ne pacientet me KA	31
Figura 8: Ecuria e intesitetit te injektimit (eritemes) konjativale te pacientet me KA	32
Figura 9: Ecuria e intesitetit te lotimit ne pacientet me KA	33
Figura 10: Ecuria e monitorimit te nevojave farmakologjike te pacienteve me KA	34
Figura 11: Ecuria e intesitetit te teshtitjes ne pacientet me RA	35
Figura 12: Ecuria e intesitetit te sekrecionit nazal ne pacientet me RA	36
Figura 13: Ecuria e intesitetit te obstrukcionit nazal ne pacientet me RA	37
Figura 14: Ecuria e monitorimit te nevojave farmakologjike te pacienteve me RA	38
Figura 15: Ecuria e intesitetit te kolles ne pacientet me AB	39
Figura 16: Ecuria e intesitetit te dispnese ne pacientet me AB	40
Figura 17: Ecuria e intesitetit te fishkellimes bronkiale (wheezing) ne pacientet me AB	41
Figura 18: Ecuria e intesitetit te shtrengimit ne gjoks ne pacientet me AB	42
Figura 19: Ecuria e monitorimit te nevojave farmakologjike te pacienteve me BA	43
Figura 20: Ecuria e intesitetit te pruritit okular ne pacientet e trajtuar me akariene	44
Figura 21: Ecuria e intesitetit te eritemes okulare ne pacientet e trajtuar me akariene	45
Figura 22: Ecuria e intesitetit te lotimit okular ne pacientet e trajtuar me akariene	46
Figura 23: Ecuria e intesitetit te teshtitjes ne pacientet e trajtuar me akariene	47
Figura 24: Ecuria e intesitetit te sekrecionit nazal ne pacientet e trajtuar me akariene	48
Figura 25: Ecuria e intesitetit te obstrukcionit nazal ne pacientet e trajtuar me akariene	49
Figura 26: Ecuria e intesitetit te kolles ne pacientet e trajtuar me akariene	50
Figura 27: Ecuria e intesitetit te dispnese ne pacientet e trajtuar me akariene	51
Figura 28: Ecuria e intesitetit te wheezing ne pacientet e trajtuar me akariene	52
Figura 29: Ecuria e intesitetit te shtrengimit ne gjoks ne pacientet e trajtuar me akariene	53

	Faqja
Figura 30: Ecuria e monitorimit farmakologjik te pacienteve te trajtuar me akariene	54
Figura 31: Ecuria e intesitetit te pruritit okular ne pacientetet e trajtuar me polene	55
Figura 32: Ecuria e intesitetit te lotimit ne pacientetet e trajtuar me polene	56
Figura 33: Ecuria e intesitetit te teshtitjes ne pacientetet e trajtuar me polene	57
Figura 34: Ecuria e intesitetit te sekrecionit nazal ne pacientetet e trajtuar me polene	58
Figura 35: Ecuria e intesitetit te kolles ne pacientetet e trajtuar me polene	59
Figura 36: Ecuria e intesitetit te dispnese ne pacientetet e trajtuar me polene	60
Figura 37: Ecuria e intesitetit te wheezing ne pacientetet e trajtuar me polene	61
Figura 38: Ecuria e intesitetit te shtrengimit ne gjoks ne pacientetet e trajtuar me polene	62
Figura 39: Ecuria e monitorimit farmakologjik te pacienteve te trajtuar me polene	63

Permbledhje

Konjuktiviti alergjik (KA), riniti alergjik (RA), dhe astma bronkiale (AB) konsiderohen patologji alergjike IgE-vartese, trajtimi i te cilave konsiston ne mjekim farmakologjik dhe imunoterapi specifike (ITS). Qellimi i ketij studimi eshte te vleresoje simptomatologjine klinike dhe monitoroje mjekimin mbajtes te pacienteve keto patologji pergjate trajtimit me ITS. Pacientet e diagnostikuar me KA, RA dhe AB dhe qe nisen ITS me administrim subkutan gjate periudhes janar 2008 – dhjetor 2012 (Lofarma, Itali) u ndoqen pergjate 3 viteve ne vijim. Nje pyetesor qe perfshinte shkallen e simptomave klinike te ketyre patologjive si dhe llojet e medikamenteve mbajtese u plotesua nga pacienti ne fillim te ITS, pas nje dhe tre vitesh (0 – mungon, 4 – shprehje maksimale per simptomat, dhe pergjigje po ose jo per perdorimin ose jo te medikamenteve). Te dhenat u paraqiten ne vlere proporcionale, dhe krahasimet u realizuan me ane te testit Fisher ekzakt. $P < 0.05$ u koniderua sinjifikativisht e rendesishme. Te dhenat e ketij studimi treguan se si simptomat klinike edhe perdorimi i medikamenteve ne shumicen e rasteve u reduktuan ne menyre sinjifikante qe pas vitit te pare te trajtimit, pavaresisht nga lloji i alergjenit, apo patologjia e trajtuar. Glukokortikoidet orale u menjanuan teresisht nga terapia mbajtese brenda vitit te pare te trajtimit, kurse antihistaminiket ishin me te perdorshmit edhe pas tre vitesh nga fillimi i ITS. Si konkluzion, mund te shprehem se monitorimi i simptomatologjise dhe mjekimit mbajtes mund te jete i dobishem ne vleresimin e efikasitetit te ITS.

Fjale-kyç: imunoterapia specifike, konjuktiviti alergjik, riniti alergjik, astma bronkiale, pikezimi klinik, monitorimi i mjekimit mbajtes.

Summary

Allergic conjunctivitis (AC), rhinitis (AR), and bronchial asthma (BA) are allergic IgE-mediated pathologies, while their management consists on pharmacological treatment and specific immunotherapy (SIT). This study aims to evaluate clinical symptoms and monitor maintenance treatment of patients during. Subjects with AC, AR, or/and BA who initiated subcutaneous SIT during period January 2008 – December 2012 (Lofarma, Italy) are monitored along 3 years. A questionnaire that compromised a clinical score for relative symptoms and maintenance medicaments is filled out by every patient at beginning of SIT, as well as 1 and 3 years later (0 – absent, 4 – maximal expression of symptom; yes/no answer for treatment with a subclass medication). Data are shown as proportion, and comparisons are undergone due to Fisher exact test. $P < 0.05$ was considered as significant. Study data demonstrated that both symptoms score and medicaments need were significantly reduced in the majority of cases during the first SIT, independently to allergen type or pathology. Oral glucocorticoids were completely eliminated from the treatment within the first year, whereas antihistamines were the mostly used during the SIT. In summary, this study demonstrates that symptom score and medication monitoring can be useful in the evaluation of SIT efficacy.

Key-words: specific immunotherapy, allergic conjunctivitis, allergic rhinitis, bronchial asthma, symptom score, medication monitoring.

1 Hyrje

1.1 Semundjet Respiratore IgE-vartese

Riniti alergjik (RA) dhe konjuktiviti alergjik (KA) apo ne nje pjese te rasteve edhe astma bronkiale (AB), konsiderohen patologji alergjike me etipatogjeneze IgE-vartese (Pfaar dhe bp. 2014, Purkey dhe bp. 2013). “Ne fillim te shekullit 20-te, alergjite konsideroheshin semundje te rralla”, kurse “pergjate dekadave te kaluara kane paraqitur nje shtim dramatik te prevalences dhe ngarkeses se tyre” (Bjorksten dhe bp. 1998, Mingomataj 2007, Papadopoulos dhe bp. 2012, Xhixha dhe bp. 2013, Xhixha dhe bp. 2015-a). Aktualisht, “alergjite perfaqesojne patologjiine me te perhapur kronike te Europes, duke prekur me teper se 60 milion njerez” (Papadopoulos dhe bp. 2012). “Te dhena nga burime te ndryshme tregojne per rritje gjithë-boterore te prevalences se astmes apo rinitit alergjik, veçanerisht ne vendet anglisht-folese” (Davies dhe bp. 1998, Mingomataj 2007, Papadopoulos dhe bp. 2012). Keshtu pergjate viteve 90, “prevalenca e wheezing apo hiper-reaktivitetit bronkial ne femijet europiane me moshe 13-14 vjeçare varionte nga 32.2% ne Britanine e Madhe deri vetem ne 2.6% ne Shqiperi”, dhe “variacione te ngjashme te dhenash mbi patologjiite alergjike te traktit respirator jane raportuar ne vendet europiane dhe me gjere edhe per te rriturit e moshes 20-44 vjeçare (Asher dhe bp. 2006, Bjorksten dhe bp. 1998, ISAAC Steering Committee 1998, Mingomataj 2007, Papadopoulos dhe bp. 2012, World Health Organisation 2005 (shiko edhe Figuren 1), ECRHS Committee 1996). Megjithë prevalencen e ulet te patologjiive alergjike respiratore, te dhena indirekte tregojne qe edhe te popullata e vendit tone ka pasur nje shtim sado te lehte te ketyre semundjeve edhe perpara viteve 90 (Bakiri dhe bp. 2015, Mingomataj dhe bp. 2008, Xhixha dhe bp. 2015-b).

1.1.1 Riniti dhe Konjuktiviti Alergjik

Riniti dhe konjuktiviti alergjik perbejne dy patologjiite kryesore alergjike IgE vartese qe prekin rruget e siperme respiratore dhe mukozat e tjera qe bien ne kontakt me ambientin e jashtem. Per shkak te bashke-shoqerimit te shpeshte te tyre, keto patologji njihen edhe me emrin e perbashket rino-konjuktiviti alergjik (D’Amato 2000, Holgate & Church 1993, Milgrom dhe bp. 2004).

Klinikisht, keto patologji shfaqen me kruarje sysh, lotim skuqie te konjuktivave (KA), si dhe obstrukcion nazal, teshtima te shpeshta sekrecione te ujshme dhe prurit nazal (RA). KA dhe RA duhen dalluar nga format e tjera joalergjike te rinit dhe konjuktivitit, si ato infeksioze, nga kontakti me trupat e huaj, me natyre vazomotore apo ato me infiltrim eozinofilik (Holgate & Church 1993, Milgrom dhe bp. 2004, Papadopoulos dhe bp. 2012). Shtrirja e tyre (disa) mujore pergjate periudhave te polenizimit, apo acarimi i tyre ne ambientet e brendshme sidomos ne stine te caktuara mund te sherbeje si nje kriter klinik diferencues (D'Amato dhe bp. 2001, Holgate & Church 1993, Milgrom dhe bp. 2004).




Figura 1: Prevalenca e astmes bronkiale gjate viteve 90 (Bull World Health Organ, Vol. 83, N 7, Genebra Jul. 2005, <http://www.who.int/bulletin>).

1.1.2 Astma Bronkiale

Astma bronkiale është një patologji e rrugëve të poshtme respiratore, e cila shfaqet me praninë në formë krizash të kolles, shtrengimit në gjoks, dispnëse, dhe fishkëllimave të gjoksit (wheezing) (Holgate & Church 1993, Milgrom dhe bp. 2004). Format e kesaj sëmundjeje janë të ndryshme, por ato mund të ndahen në formën alergjike (IgE-vartese dhe jo IgE-vartese). Pergjithësisht, forma IgE-vartese shfaqet me heret, shoqërohet me patologji të tjera IgE-vartese, dhe shperthen pas ekspozimit ndaj alergjeneve të ndodhur në ajër (Bousquet dhe bp. 2002, Holgate & Church 1993, Milgrom dhe bp. 2004, Papadopoulos dhe bp. 2012, Xhixha dhe bp. 2015-a). Ndodh, që ajo të konsiderohet si episode infeksionesh të shpeshta respiratore dhe duhet dalluar edhe nga patologji të tjera të lidhura me ekspozimin ngaj në faktori ambiental si astma okupacionale apo alveoliti alergjik (Holgate & Church 1993, Milgrom dhe bp. 2004, Papadopoulos dhe bp. 2012, Xhixha dhe bp. 2015-b).

1.2 Pergjigja IgE-vartese dhe Patologjite Respiratore

Imunoglobulina E përben një klasë të antikorpeve të ndodhura vetëm të gjitarëve (Vernersson 2002, Vernersson dhe bp. 2002). Përben një klasë globulinash që zakonisht ndodhet në nivel të ulët serik, nuk lidhin komplementin, nuk kalojnë barrierën placentare dhe ndryshe nga antikorpet e tjera kanë një domen me teper në pjesën Fc të tyre (Mingomataj & Bakiri 2011, Roitt dhe bp. 2001, Vernersson dhe bp. 2002). Sintetiza e IgE-ve nga një klon limfocitar B i caktuar përben fazën finale të kembimit të prodhimit të immunoglobulinave, dmth një klon limfocitar B pas sekretimit fillestar nga plazmocitet që rrjedhin prej tyre të IgM, mund të kembejnë atë me prodhimin e IgG, dhe me tej ndoshta me atë të IgE, kurse e kundërta (pra nga prodhimi i IgE në IgG prej të njëjtit klon limfocitar B) nuk mund të ndodhë (Roitt dhe bp. 2001).

Lidhur me patologjite respiratore IgE-vartese mund të thuhet se rol klinik kanë vetëm IgE-të specifike ndaj alergjeneve shkaktare të manifestimeve klinike (Holgate & Church 1993, Milgrom dhe bp. 2004). Niveli i ngritur serik i IgE-ve specifike shoqërohet me një pergjigje imune të tipit T helper (Th) 2, e shoqëruar me nivele të larta të interleuines (IL)-4, IL-5, IL-13, etj (Milgrom dhe bp. 2004, Roitt dhe bp. 2001). Prania e IgE-ve specifike qofte edhe në nivele të pamatshme në serum por të detektueshme në mukozë është një parakusht për praninë e një patologjie respiratore IgE-vartese, por kurresesi prania e tyre në serum (apo aq me teper edhe e IgE totale)

ne nje individ te caktuar nuk tregon se personi ne fjale eshte i prekur domosdoshmerisht nga nje prej patologjive ne fjale (Milgrom dhe bp. 2004, Mingomataj dhe bp. 2006).

Vetem nese organizmi ndodhet ne nje gjendje neuro(psiko)-immunologjike te caktuar, si pasoje e se ciles ndodh degranulimi mastocitar pas urezimit te IgE-ve specifike te ndodhura ne receptoret perkates me ane te alergjenit mund te flasim per nje pergjike klinike relevante IgE-vartese (Holgate & Church 1993, Milgrom dhe bp. 2004, Mingomataj 2011, Mingomataj & Bakiri 2012, Roitt dhe bp. 2001). Megjithate, pacientet ne fjale mund te pesojne simptomatologjine klinike edhe jashte kohes se ekspozimit ndaj alergjenit pergjegjes si pasoje e kronicizimit te patologjise. Si trigger mund te sherbejne ndotes te ndryshem, situhatat e renda emocionale, apo infeksione te ndryshme te traktit respirator (Holgate & Church 1993, Mingomataj & Bakiri 2012).

1.3 Diagnoza e Patologjive Respiratore Alergjike IgE-vartese

Diagnoza e patologjike alergjike respiratore IgE-vartese mbeshetet ne kombinimin e te dhenave anamnesticke te ankesave dhe simptomave te permendura nga pacienti, ekzaminimi objektiv, si dhe analizat e ndryshme in-vivo dhe in-vitro (D'Amato dhe bp. 2001, Milgrom dhe bp. 2004, Przybilla dhe bp. 2000). Simptomave te permendura me siper, mund tu shtohen edhe te dhena te ndryshme objektive, funksionale dhe laboratorike, si erimema e mukozave nazale dhe okulare, prania e eozinofileve dhe citokinave eozinofilike ne sekrecionet e rrugeve respiratore, zbulimi i obstrukcionit nazal dhe bronkial perkatesisht me ane te rinomanometrise dhe spirometrise, etj (D'Amato dhe bp. 2001, Milgrom dhe bp. 2004, Przybilla dhe bp. 2000).

Nderkaq, sensibilizimi ndaj nje atopeni aerogen mund te evidentohet ne rutine in-vivo me ane te testeve kutane prick, apo in-vitro me ane te matjes se nivelit te IgE-ve specifike me ane te Radio-Allergen-Sorbent-Test (RAST), apo metodave te tjera akoma me efikase (D'Amato dhe bp. 2001, Milgrom dhe bp. 2004, Przybilla dhe bp. 2000). Duhet theksuar qe vetem kur shfaqia e simptomave respiratore si pasoje e pranise se alergjenit ne ajer perkon me pranine e sensibilizimit te personit ndaj alergjenit perkates, ben qe nje test pozitiv in-vivo apo in-vitro te konsiderohet linikisht i rendesishem, pasi siç u permend me siper, prania e IgE-ve specifike ne serum nuk lidhet domosdoshmerisht me sensibilitetin klinik nga alergjenit te dyshuar (Milgrom dhe bp. 2004, Mingomataj dhe bp. 2006, Przybilla dhe bp. 2000). Ne rast dyshimi, provokimi topikal me alergjenin e dyshimte dhe observimi pasues per shfaqien e simptomave alergjike perkatese mund

te ndihmoje ne percaktimin perfundimtar te pranise se sensibilizimit klinikisht te rendesishem (Przybilla dhe bp. 2000).

1.4 Trajtimi i Patologjive Respiratore IgE-vartese

Trajtimi i patologjive respiratore IgE-vartese konsiston ne menjanimin sa te jete e mundur te kontaktit me alergenin pergjegjes, trajtimin farmakologjik me medikamente te grupeve te ndryshme, dhe perdorimin e imunoterapise specifike (ITS) (Holgate & Church 1993). Ne menjanimin e kontaktit perfshihen disa masa praktike por jo domosdoshmerisht efektive qe tentojne te ulin e perqendrimit e alergeneve ne nje ambient te caktuar, si mbajtja e dritareve mbyllur ne pranvere, perdorimi i mjeteve qe nuk ngrene pluhur ne shtepi gjate pastrimit, menjanimi nga perdorimi i objekteve qe mbajne pluhur ne ambientet e banimit te personit te sensibilizuar, perdorimi i akaricideve, etj (D'Amato dhe bp. 2000).

Ne trajtimin farmakologjik perfshihet nje game e gjere medikamentesh, te cilat konsiderohen si mjetet me efektive (kundrejt dhe çmimit) dhe qe perdoren me gjeresisht nga pacientet e prekur nga patologjite respiratore IgE-vartese. Ketu perfshihen medikamentet antihistaminike, glukokortikoidet topike dhe orale, beta-agonistet me veprim te shkurter apo te gjate, bllokoret e receptoreve leukotrienike, kromoglikatet, antikorpet anti-IgE, etj (Milgrom dhe bp. 2004). Nuk mund te lihet pa permendur edhe mjetet e trajtimit qe nuk i perkasin trajtimit klasik farmakologjik si homeopatia, akupunktura apo ato autosugestionuese.

Antihistaminiket perdoren gjeresisht ne trajtimin e rinokonjuktivitit alergjik, dhe rralle ne pacientet astmatike, me nje efektivitet te konsiderueshem sidomos ne frenimin e disa simptomave nazale e me pak ato okulare (D'Amato dhe bp. 2000, Holgate & Church 1993, Milgrom dhe bp. 2004, Papadopoulos dhe bp. 2012). Glukokortikoidet nga ana e tyre, konsiderohen si medikamentet me efektive duke ndikuar njekohesisht ne gjithë simptomatologjine alergjike respiratore. Mjekimi topik me glukokortikoide konsiderohet si mjekim prevenues por jo me efekt te menjehershëm ne frenimin e simptomave alergjike. Kurse glukokortikoidet orale, perbejne nje mjet te fuqishem ne shuarjen e simptomave, por konsiderohet si jo shume i deshirueshem per shkak te efekteve negative, sidomos atyre te lidhur me perdorimin e gjate (D'Amato dhe bp. 2000, Holgate & Church 1993, Milgrom dhe bp. 2004, Papadopoulos dhe bp. 2012). Beta-agonistet konsiderohen si medikamentet me efektive ne frenimin e simptomave te astmes, duke u perdorur si ne kriza (kryeshisht beta-agonistet me

veprim te shkurter), edhe si mjekim mbajtes (kryeshisht beta-agonistet me veprim te zgjatur). Nderkaq, bllokuesit e receptoreve leukotrienike konsiderohen medikamente me efektshmeri te limituar, qe perdoren ose ne forma te lehta te patologjive, ose si medikamente shtese per te ulur sado-pak konsumin e glukokortikoideve, ose ne trajtimin e pacienteve astmatike qe refuzojne perdorimin e pompave (D'Amato dhe bp. 2000, Holgate & Church 1993, Milgrom dhe bp. 2004, Papadopoulos dhe bp. 2012). Kromoglikatet jane po ashtu medikamente me nje efekt te kufizuar qe mund te perdoren kryeshidht ne trajtimin e rino-konjuktivitit alergjik. Se fundmi, nje perdorim gjithnje e me te perhapur po gjen edhe trajtimi me antikorpe anti-IgE, duke perbere nje alternative qe ndikon ne mekanizmat etiopatogjenetike te patologjive alergjike respiratore (Papadopoulos dhe bp. 2012).

Nje shtylle tjetere baze e trajtimit te patologjive respiratore IgE-vartese perben perdorimi i ITS (D'Amato dhe bp. 2012). Deri me sot, ITS perben te vetmin trajtim etiopatogjenetik aktiv dhe perdorim te gjere te patologjive alergjike IgE-vartese (Karakoc dhe bp. 2012, Pfaar dhe bp. 2014, Purkey dhe bp. 2013). Ajo konsiderohet jo vetem nje mjet qe frenon shfaqjen e simptomave alergjike dhe mjet i pakesimit te konsumit te medikamenteve anti-alergjike, por edhe mjet i frenimit te marshit alergjik apo te shtrirjes se simptomatologjise nga kati respirator i siperm ne ate te poshtem apo i ndalimit te zgjerimit te games se alergeneve ndaj te cileve personi alergjik eshte i ndieshem (D'Amato dhe bp. 2000, Bousquet dhe bp. 2002, Xhixha dhe bp. 2015-a, Xhixha dhe bp. 2015-b). Lidhur me patologjite respiratore IgE-vartese, eshte pranuar qe ITS paraqet efektivitet dhe siguri me te larte ne rast se perdoret ne trajtimin e pacienteve me rino-konjuktivitit alergjik sesa ne rastin e pacienteve me astme bronkial te instaluar (D'Amato dhe bp. 2000, Papadopoulos dhe bp. 2012).

1.5 Mekanizmi i Veprimit te ITS

“ITS me alergene perfaqeson nje kend-themeli te trajtimit te patologjive IgE-vartese, dhe ne mes te tjerash, mekanizmat e ITS perfshijne desensibilizimin e bazofileve dhe mastociteve, si dhe gjenerimin e pergjigjes se qelizave rregullatore T dhe B” (Akdis & Akdis 2014-a, Akdis & Akdis 2014-b (shiko edhe Figuren 2), Incorvaia 2013, Matsuoka dhe bp. 2013, Mingomataj & Bakiri 2016, Soyka dhe bp. 2012, Yamanaka dhe bp. 2014). Nxitja e qelizave T rregullatore CD4/CD25, prodhimi i interleukines IL-10 dhe faktorit TGF- β , sjell nje kembim te pergjigjes imune nga Th2ne drejtim te Th1, gje qe karakterizohet nga nje nivel i rritur i interferonit IFN- γ ,

prodhim të IgG-ve specifike, etj (Mingomataj dhe bp. 2006). Për më tepër, “devijimi i qelizave efektore T dhe B specifike për alergjenin në një fenotip rregullator shfaqet si një ngjarje çelës përgjatë ITS”, dhe së fundmi, “qelizat B që nxisin sekretimin e IL-10 po ashtu janë pare të kontribuojnë në nxitjen e tolerancës ndaj alergjenit nëpërmjet frenimit të qelizave T efektore dhe nxitjes selektive të izotipit antikorpale IgG₄” (Akdis & Akdis 2014-a, Incorvaia 2013, Getts dhe bp. 2013). “Frenimi i hershem i qelizave të lindura efektore të involuara në inflamacionin alergjik si mastocitet dhe bazofilet, rregullimi i përgjigjeve pro-alergjike Th2 dhe qelizore B IgE⁺ janë pare të ndodhin përgjatë ITS si në inde edhe në gjakun periferik” (Akdis & Akdis 2014-a, Matsuoka dhe bp. 2013, Mingomataj & Bakiri 2016). “Gjendja tolerogjenike ndaj alergjenit pas ekspozimit ndaj përqendrimeve të larta të mostrave molekulare të lidhura me patogjenin shoqërohet me nxitjen lokale dhe sistematike të popullatave të dallueshme limfocitare rregullatore T, përfshi qelizat T rregullatore Tr1, TGF-β⁺ dhe qelizave rregullatore të kujtesës FoxP3⁺” (Akdis & Akdis 2014-a, Getts dhe bp. 2013, Incorvaia 2013, Matsuoka dhe bp. 2013, Platts-Mills & Woodfolk 2011). “Nxitja e IL-10, Th1 dhe qelizave T rregullatore frenon po ashtu neurokininat si faktorin e rritjes nervore NGF, duke nxitur kështu bllokimin e hiperreaktivitetit të rrugëve të ajrit apo simptomat e tjera alergjike” (Matsuoka dhe bp. 2013, Shi dhe bp. 2012). “Target potencial i ITS mund të jenë qelizat antigen-prezantuese si qelizat dendritike ose monocitet, të cilat mund të rikthejnë tolerancë në mjaft modele përfshi këtu edhe alergjinë IgE-vartese” (Escobar dhe bp. 2014, Matsuoka dhe bp. 2013, Mingomataj & Bakiri 2016, Yamanaka dhe bp. 2014). “Mekanizma alternative të tolerancës përfshijnë apoptozën apo delecionin e qelizave Th2 specifike të kujtesës dhe/ose një dështim të bashkë-stimulimit, i cili shpie në anergjinë e qelizore T” dhe një përfshirje të gjërë të faktoreve të ndryshëm imunitarë (Asher dhe bp. 2013, Getts dhe bp. 2013, Matsuoka dhe bp. 2013).




Figura 2: Mekanizmat e tolerances se alergenit. “Nxitja e qelizave alergen-specifike Tregs, te cilat transformohen nga qeliza Th2 alergen-specifike eshte nje nga ngjarjet fillestare ne zhvillimin e tolerances se alergenit. Qelizat efektore te inflamacionit alergjik – mastocitet bazofilet, dhe eozinofilet, rregullohen funksionet shtypese dhe rregullatore te qelizave Tregs ne rruge te shumta. IL-10 dhe TGF- β e sekretuar nga qelizat Treg frenojne keto qeliza. Qelizat Tregs poashtu frenojne qelizat Th2 dhe citokinat e tyre, duke parandaluar furnizimin e faktoreve mbijetues per keto qeliza efektore te alergjise. IL-10 dhe TGF- β frenojne prodhimin e IgE-ve nga qelizat B, dhe nderkaq, IL-10 nxit (prodhimin e) IgG₄. Qelizat rregullatore B (Bregs) qe prodhojne IL-10 luajne nje rol ne frenimin e qelizave T alergen-specifike dhe kryesisht transformohen ne plazmocite prodhuese te IgG₄. (Receptori histaminik) H2R luan nje rol ne frenimin e qelizave Th2, qelizave dentitrike inflamatore, dhe bazofileve” (Akdis & Akdis 2014-b downloaded from <http://www.jci.org> on February 25, 2016. <http://dx.doi.org/10.1172/JCI78891>).

1.6 Ekstraktet e Alergeneve, Cilesite dhe Perdorimi i Tyre

Ekstraktet e alergenit jane nje pergatitje me permbajtje alergeni te perftuar nga ekstraktimi i perberesve aktive te substancave shtazore apo vegjetale me nje menstruum te pershtatshem. Per imunoterapine produktet mund te jene te pamodifkuara ose te modifkuara kimikisht dhe/ose ne brendesi te konservuesve te ndryshem nepermjet absorbimit. Ato ndahen ne:

- Vaksina ujore
- Depo dhe vaksina te modifkuara
- Miksture e vaksinave

1.6.1 Cilesite e Alergeneve te ITS

Cilesia e vaksines eshte e rendesishme per diagnozen dhe trajtimin. Kur eshte e mundur, duhet te perdoren vaksina te standartizuara me fuqi dhe gjysem-jete plazmatike te njohur. Standartizimi percakton “fuqine” se ekstraktit alergjenik dhe garanton qe seria e vaksinave te prodhuara nga lote te ndryshme te lendes se pare te perputhet dhe te kene aktivite te krahasueshme.

Standartizimi mund te behet:

- Biologjikisht: fuqia e vaksines krahasohet me pergjigjen kutane te perftuar ne nje popullate te referuar
- Immunologjikisht: fuqia e vaksines eshte bazuar ne eksperimente RAST-inhibition duke perdorur standart pools of sera

Per kete perdoren njesi te ndryshme:

- Protein nitrogen units (PNU- ne gjithe boten)
- Allergy unit (AU- U.S. FDA)
- Bioequivalent allergy unit (BAU)
- Biologic units (BU- Europe)
- International unit (IU- WHO)
- Index of reactivity (IR- Europe)
- Specific treatment unit (STU)
- Activity Units by RAST (AUR- Europe)
- Ekstraktet e standartizuara te alerogeneve jane te rendesishem per diagnozen dhe trajtimin e alergjise



Figura 3: Ekstrakt alergjenik i standartizuar per perdorim subkutan

Ekstraktet e disa alergjeneve kane permbajtje proteaze. Ajo ka aftesine te degradoje proteinat e ekstrakteve me te cilat perzihet. Proteaza jane raportuar ne mykra dhe ne ekstraktet e gjithe trupit te insekteve. Nuk duhet te perzihen ekstraktet e cockroach ose mykrave me polenet dhe akarienet.

Allergenic Extract	Protease-containing Extracts			Comments
	Insects	Fungi	Mites	
Insects	⊘	⊕	⊕	Whole-body insect extracts contain very high protease levels; susceptible to endogenous proteases unless stored in 50% glycerin
Fungi	⊕	⊕	⊕	Fungal extracts do not appear to be adversely affected by proteases;
Mites	⊘	⊘	⊕	Mite allergens resistant to insect and fungal proteases if stored in ≥ 10% glycerin.
Pollens	⊗	⊗	⊕	Pollen extracts susceptible to insect and fungal proteases; compatible with mite extracts when stored in ≥ 10% glycerin.
Cat hair/epithelia	⊕	⊕	⊕	Fel d 1 in cat extract is highly resistant to fungal and insect proteases
Dog hair/epithelia	⊕	⊘	⊕	Dog allergens susceptible to most fungal extracts, but more stable when mixed with insect extracts.

Figura 4: Alergenet me permbajtje proteazash

WHO POSITION PAPER¹: Mixtures of unrelated allergens are not recommended.

A - Allergen mixtures

ALLERGENS	POLLENS	MITES	EPITHELIA	MOULDS	
POLLENS	Green	Red	Red	Red	unrelated allergens, mixture not recommended by WHO
MITES	Red	Green	Red	Red	
EPITHELIA	Red	Red	Green	Red	related allergens, mixture possible
MOULDS	Red	Red	Red	Green	

Figura 5: Miksturat alergenike te parekomanduara nga OBSH si pasoje e pranise se proteazave

1.6.2 Menyra e Perdoritimit te Alergeneve te ITS

Imunoterapia specifike konsiston ne administrimin e dozave te perseritura gradualisht ne rritje te alergenit ne subjektin alergjik deri ne dozen mbajttese, dhe pas kesaj, ajo administrohet sipas skemave te caktuara per nje periudhe disa-vjeçare me qellim qe te aktivizohen mekanizma imunomodulatore dhe permiresimin e simptomave pas ekspozimit te ardhshem ndaj alergenit natyral. Gjate pershkrimit te recetes duhet te caktohen:

- Ekstrakti alergjeni do te pershkruhet
- Doza mbajttese kur eshte provuar qe eshte klinikisht efektive
- Fuqia e disponueshme e ekstraktit te alergenit
- Skemat e reaksionit te kryqezuar dhe
- Efektet e demshme te disa ekstrakteve mbi te tjerat me te cilat mund te perzihen

Po ashtu duhet te merret parasysh edhe prania e faktoreve te riskut per efekte anesore gjate aplikimit te ITS, si:

- Asthma e pakontrolluar
- Asthma e rende
- Perdorimi i beta bllokuesve
- Ngritja e dozes gjate fazes initiale (build-up)
- Perdorimi i flakoneve te rinj
- Gabimet teknike

1.6.3 Rruget e Administrimit dhe Teknika e Injektimit Subkutan

ITS administrohet me keto ruge:

- Subkutane (SCIT)
- Sublinguale (SLIT)
- Orale (OIT)
- Nazale (LNIT)
- Bronkiale (LBIT)
- Intralimfatike (IL)

Ndersa teknika e injektimit subkutan te alergjenit (gjate trajtimit me SCIT) eshte pershkruar si me poshte:

- Injektohet ne siperfaqen e jashtme te siperme te krahut
- Duhet te ruhet steriliteti ne vendin e injektimit
- Perdorim i shiringave 1 ml dhe age portokalli
- Injektohet ne nje kend 45° subkutan
- Duhet te regjistrohet çdo reaksion lokal/sistemik



Figura 6: Teknika e injektimit subkutan te alergjenit gjate trajtimit me SCIT

1.7 Qellimi i Studimit

Te dhenat nga literatura nderkombetare mbeshtet efektshmerine klinike te ITS, kurse te dhenat nga Shqiperia jane te kufizuara dhe kryesisht te paraqitura vetem ne evente te ndryshme (Karakoc dhe bp. 2012, Pfaar dhe bp. 2014, Pfaar dhe bp. 2015, Purkey dhe bp. 2013, Song dhe bp. 2015-a, Song dhe bp. 2015-b). Nje mjet te perdorur gjeresisht per vleresimin e matjes se efikasitetit te ITS perbejne pyetesoret e monitorimit te pikezimit klinik (PK), si dhe ai vleresimit te nevojës per perdorimin e medikamenteve perkatese (Pfaar dhe bp. 2014, Potter dhe bp. 2015, Song dhe bp. 2015-b). Ky mjet eshte lehtesisht i perdorshem, nuk kerkon kualifikim te ngritur te

pacienteve, dhe investimi financiar eshte i kufizuar krahasuar me mjetet e monitorimit me markues laboratorike, etj. Po ashtu, astma bronkiale alergjike eshte konsideruar si factor risku per efekte anesore dhe kunderindikim relative per perdorimin e ITS. Duke patur keto te dhena, vendosem te kryejme nje studim prospektiv (follow-up 3-vjeçar) te efektit te ITS mbi simptomat dhe trajtimin farmakologjik te pacienteve me KA, RA apo AB (te kontrolluar).

Qellimi i ketij studimi eshte te monitoroje shkallen e shprehjes se simptomatologjise klinike dhe nevojen e perdorimit te medikamenteve antialergjike te pacientet me KA, RA apo AB te kontrolluar pergjate trajtimit me ITS (forma SCIT), ne menyre qe te vleresohet edhe efikasiteti i tij.

Per kete, objektivat perkatese konsistojne ne:

- a) Vleresimin subjektiv te shprehur numerikisht te intesitetit te seciles prej simtomave klinike te patologjise prej nga eshte prekur pacienti ne fillim, pas nje viti dhe pas tre vitesh nga nisja e ITS subkutane duke krahasuar te dhenat per te percatuar rolin e trajtimit mbi keto simptoma dhe kesisoj edhe efikasitetin e tij.
- b) Vleresimi me ane te nje pergjigjeje pohuese apo mohuese te nevojes per te konsumuar secilin nga medikamentet e perdorur ne patologjine prej se ciles eshte prekur pacienti para nisjes se ITS, pas nje viti dhe pas tre vitesh nga nisja e ITS, duke krahasuar te dhenat per te percatuar rolin e trajtimit mbi keto nevoja farmakologjike dhe kesisoj edhe efikasitetin e tij.

2 Materiali dhe Metoda

2.1 Diagnostikimi dhe Perfshirja/Perjashtimi i Pacienteve

Diagnoza klinike u vendos nga nje mjek alergolog duke u mbeshtetur ne proven respiratore, testet kutane me pneumoalergene (Lofarma, Itali) apo IgE specifike (me vlere te perqendrimit serik $>0.35\text{UI/l}$) per nje sere aeroalergenesh mesdhetare. Ne bashkepunim me pacientet te cilet ishin nderkohe nen trajtim terapeutik, u vendos perfshirja e 94 prej tyre ne ITS me alergenin pergjegjes (administrim subkutan, Lofarma, Itali) gjate viteve 2008-2013 dhe ndjekja klinike e tyre pergjate te pakten 3 viteve ne vijim. U perjashtuan nga studimi, personat me patologji te tjera te cilat interferonin ne simptomatologjine e siper-permendur, personat qe nuk e vijuan mjekimin pergjate tre viteve per aresye te ndryshme jo-klinike, personat me forma te pakontrolluara te astmes bronkiale (me disfuksion ventilator obstruktiv te pakten mesatar), apo persona astmatike perdorues te duhanit, apo paciente astmatike qe perdornin medikamente qe preknin funksionin respirator gjate trajtimit te patologjive te tjera shoqeruese.

2.2 Pergatitja dhe Plotesimi i Pyetesorit te Monitorimit Klinik dhe Terapeutik

Per kete u pergatit nje pyetesor i thjeshte tabelar me te gjitha simptomat klasike te patologjive te siperpermendura dhe llojet e medikamenteve te trajtimit mbajtes, ne te cilin pacienti vleresonte ne fillim te ITS, pas nje dhe tre vitesh shkallen e shprehjes se simptomave dhe perdorimin ose jo te medikamenteve. Simptomat klinike (prutiti okular dhe nazal, lotimi, skuqia e syve, obstruksioni nazal, teshtimat, sekrecioni nazal, kolla, dispnea, shtrengimi ne gjoks dhe fishkellima e gjoksit u vleresuan subjektivisht ne menyre te shkallezuar (0 – mungon, 4 – shprehje maksimale e mundshme) ne periudhat e siper-permendura te trajtimit me ITS. Po ashtu, pacienteve (paralelisht me konsultimin e kartelave) ju kerkua te pohonin ose mohonin ne momentin e dhe ne perdorimin e rregullt te antihistaminikeve, glukokortikoideve orale, atyre lokale (nazale apo bronkiale sipas patologjise), bronkodilatatoreve dhe antileukotrieneve. Te dhenat e mesiperme u vleresuan sipas patologjive (KA, RA, dhe AB) dhe sipas alergeneve te perdorur (akariene dhe polene).

2.3 Analiza Statistikore e te Dhenave

Te dhenat u paraqiten si grafike ne vlera proporcionale (perqindje), dhe krahasimet u realizuan me ane te testit ekzakt te Fisherit per shkalle lirie nje. $P < 0.05$ u konsiderua sinjifikativisht e rendesishme. Per kete u perdoren programet MS office 2007, dhe llogaritesi online i testit ekzakt te Fisherit (<http://graphpad.com/quickcalcs/contingency1.cfm>).

3 Rezultatet

3.1 Te Dhena te Pergjithshme

Nga 94 pacientet (m 40, f 54) e pershire ne studim, u konstatua se mosha ne fillim te ITS varionte nga 6 ne 60 vjeç, mosha mesatare ishte 24 ± 1.4 vjeç, dhe vjetersia mesatare e semundjes ishte 6.17 ± 0.44 vite. Si patologji solitare apo bashke-shoqeruese u evidentuan 30 raste me KA, 87 me RA dhe 55 me AB. Shtatedhjetë e tre (73) raste u trajtuan me ekstrakte akarienesh dhe 35 me ekstrakte polenet te ndryshme (14 raste pra edhe me akariene edhe me polene).

3.2 Simptomatologjia Klinike para ITS

Nga PK rezultoi qe simptomat me te shpeshta dhe subjektivisht me intesitet me te larte ishin pruriti okular, teshtima dhe kolla, respektivisht ne KA, RA dhe AB. Para ITS, te pacientet me KA pruriti okular dhe skuqia e konjuktivave u verejt ne te 30 rastet (ku proporcionet e rasteve me forme shume te shprehur dhe maksimalisht te shprehur arrinin ne total respektivisht 53% dhe 33%), kurse lotimi mungoi ne 8 raste (forma shume e shprehur dhe maksimalisht e shprehur arrinin ne total vetem 13% – shih Figurat 7-9). Tek 87 pacientet me RA, 29 shfaqnin edhe konjuktivit kurse 49 edhe AB. Ndermjet kontigjentit ne fjale, teshtima dhe sekrecioni nazal u verejt ne te 87 rastet (ku proporcionet e rasteve vetem me forme maksimalisht te shprehur arrinin respektivisht ne 81% dhe 37%), kurse obstruksioni nazal mungoi ne 3 raste (shprehja maksimale u refereua nga afro 20% e subjekteve – shih Figurat 11-13). Te pacientet astmatike kolla u paraqit ne te 55 rastet (ku proporcioni i rasteve vetem me forme maksimalisht te shprehur arrinte ne 98%), dispnea mungoi ne 4 raste (proporcioni i rasteve vetem me forme maksimalisht te shprehur ishte mbi 20%), fishkellima e gjoksit mungoi ne nje rast (proporcioni i rasteve vetem me forme maksimalisht te shprehur ishte me pak se 4%), kurse shtrengimi ne gjoks u permend ne 41 raste (proporcioni i rasteve vetem me forme maksimalisht te shprehur perbente mbi 14% te rasteve - shih Figurat 15-18).

3.3 Terapia Farmakologjike para ITS

Para nisjes se ITS, pacientet me KA perdornin antihistaminike ne 30 raste (100%), kortikoide nazale/okulare ne 28 (93%), kortikoide orale ne 14 (47%), dhe antileukotriene ne 7 raste (23%) (shih Figuren 10). Pacientet me RA, para nisjes se ITS perdornin antihistaminike dhe kortikoide

nazale/okulare ne 86 raste (99%), kortikoide orale ne 36 (41%), dhe antileukotriene ne 18 raste (21% - shih Figuren 14). Pacientet astmatike, para ITS perdornin antihistaminike ne 49 raste (89%), kortikoide orale ne 16 (29%), kortikoide bronkiale ne 54 (98%), bronkodilatatore me veprim te zgjatur ne 29 (53%), dhe antileukotriene ne 11 raste (20% - shih Figuren 19).

3.4 Ecuria e Simptomatologjise Klinike dhe Nevojave Medikamentoze gjate ITS

3.4.1 Pacientet me Konjuktivit Alergjik

ITS te pacientet me KA reduktoi sinjifikativisht vlerat mesatare te simptomave qe pas vitit te pare duke avancuar ato edhe ne fund te vitit te trete. Respektivisht, proporcionet totale te PK me shprehje mesatare apo me te renda per pruritin okular zbriti (nga 97%) ne 70% ($p < 0.0001$) dhe me tej 10% ($p < 0.0001$), per eritemen konjuktivale (nga 63%) ne 40% ($p = 0.0093$) dhe 0% ($p < 0.0001$), kurse per lotimin keto vlere variuan (nga 43%) ne 23% ($p = 0.0187$) dhe 0% ($p < 0.0001$) (shih Figurat 7-9).

Ne keta paciente, ITS reduktoi sinjifikativisht perdorimin e antihistaminikeve vetem pas vitit te trete: ato perdoreshin perseri ne 30 raste (100%) pas vitit te pare dhe ne 20 raste (67%) ne fund te ITS ($p = 0.0008$ - shih Figuren 10). Kortikoidet orale u nderprene se perdoruri qe ne fund te vitit te pare ne te 14 rastet ($p < 0.0001$), kurse perdorimi i atyre lokale u reduktuan pjeserisht (15/30 – 50%) pas vitit te pare ($p = 0.0004$) dhe pothuajse teresisht (1/30 - 3%) pas vitit te terete te ITS ($p < 0.0001$). Reduktimi i perdorimit te antileukotrieneve ne kete kontigjent pacientesh ishte statistikisht i konsiderueshem vetem ne fund te ITS edhe pse perdorimi i tyre pas vitit te pare qe fare i rralle. Pas vitit te pare ky lloj medikamenti u perdor akoma ne 1 rast (3%) ($p = 0.0523$) dhe ne fund te ITS nuk perdorej me fare ($p = 0.0105$ – shih Figuren 10).

3.4.2 Pacientet me Rinit Alergjik

Lidhur me pacientet me RA, proporcioni total i PK me shprehje mbi mesatarisht te rende per teshtimen u reduktua pas nje viti dhe tre vitesh (nga 98%) respektivisht ne 86% ($p < 0.0001$) dhe me tej ne 3% ($p < 0.0001$), sekrecionin nazal (nga 77%) ne 44% ($p < 0.0001$) dhe 0% ($p < 0.0001$), ndersa per obstrukcionin nazal keto vlere zbriten (nga 33%) respektivisht ne 17% ($p < 0.0001$) dhe 0% ($p < 0.0001$) (shih Figurat 11-13).

Ne keta paciente, konsumi i antihistaminikeve u reduktua vetem pas vitit te trete te ITS. Pas vitit te pare keto medikamente perdoreshin akoma nga 84 paciente (97%, $p = 0.62$), kurse pas vitit te trete te ITS ne 61 raste (70%, $p < 0.0001$ - shih Figuren 14). Perdorimi i kortikoideve orale u nderpre teresisht brenda vitit te pare te ITS ($p < 0.0001$), kurse e atyre lokale u reduktua pjeserisht pas vitit te pare duke u perdorur ne 53 raste (61%, $p < 0.0001$, dhe ne menyre masive ne fund te ITS duke u perdorur ne 9 raste (10%, $p < 0.0001$). Perdorimi i leukotrieneve arriti pas vitit te pare ne 5 raste (6%) ($p = 0.0062$), dhe ne vitin e trete te ITS ne 2 te raste (2%, $p = 0.0002$ – shih Figuren 14).

3.4.3 Pacinetet me Astme Bronkiale

Persa i perket vlerave proporcionale totale te PK me intesitet mbi mesatar ne pacientet astmatike u paraqit ky kuader: per kollen pas 1 viti (nga 100%) u reduktua ne 82% ($p < 0.0001$) dhe tre vitesh ne 16% ($p < 0.0001$), (nga 37%) per dispnene ne 15% ($p = 0.0003$) dhe 2% ($p < 0.0001$), fishkellimat ne gjoks (wheezing) (nga 33%) ne 4% ($p < 0.0001$) dhe 0% ($p < 0.0001$), kurse per shtrengimin ne gjoks (nga 40%) respektivisht ne 15% ($p = 0.0004$) dhe 0% ($p < 0.0001$, shih Figurat 15-18).

ITS ne keta paciente (me patologji shoqeruese RA apo KA) arriti deri-diku te ule nevojën e perdorimit te antihistaminikeve pas vitit te trete. Pas vitit te pare ato u perdoren ne 46 raste (84%, $p = 0.5797$) dhe pas vitit te trete te ITS ne 37 prej tyre 67%, $p = 0.0101$ - shih Figuren 19).

Kortikoidet orale u menjanuan nga perdorimi qe ne fund te vitit te pare te ITS ($p < 0.0001$), kurse si ato nazale dhe ato bronkiale u reduktuan progresivisht ne perdorim. Keshtu, kortikoidet bronkiale u perdoren pas vitit te pare ne 32 raste (58%) dhe pas vitit te trete vetem ne 6 raste (11%, - ne te dy rastet: $p < 0.0001$), kurse ato nazale respektivisht ne 33 subjekte (60%) dhe 8 prej tyre (15%, - perseri ne te dy rastet: $p < 0.0001$). Po ashtu, ne keta paciente si beta-agonistet me veprim te zgjatur edhe antileukotrienet u perdoren progresivisht ne menyre me te kufizuar. Pas vitit te pare beta-agonistet u perdoren ne 15 raste (27%, $p = 0.011$) dhe pas vitit te trete te ITS ne 9 raste (16%, $p < 0.0001$), kurse antileukotrienet respektivisht ne 4 raste (7%, $p = 0.0931$) dhe 2 raste (4%, $p = 0.0153$) te rasteve duke arritur nje ndryshim te rendesishem vetem ne vitin e trete te trajtimit (shih Figuren 19).

3.4.4 Pacientet e Trajtuar me Extrakte Akarienesh

Nga vleresimi statistikor i proporcioneve PK u konstatua nje reduktim i intesitetit subjektiv te simptomave ne rastin e perdorimit te akarieneve (73 paciente). Duke i pare vlerat e çdo simptomi klinik, ndryshim sinjifikativ u verejt te pakten ne vitin e trete ne te gjitha rastet, dhe sipas patologjise se trajtuar qe pas vitit te pare me nje vlere p prej te pakten 0.01 (shih Figurat 20-29). Nderkaq, nga vleresimi statistikor i perdorimit te medikamenteve gjate ITS me akariene rezultoi qe nr i pacienteve qe perdoren antihistaminike pakesua ne menyre sinjifikante vetem pas vitit te trete te trajtimit (respektivisht, $p < 0.0001$), kurse ne rastin e perdorimit te bronkodilatatoreve me veprim te zgjatur, glukortikoive orale dhe lokale, apo antileukotrieneve nr i pacienteve u pakesua dukshem qe ne fund te vitit te pare te trajtimit (respektivisht, $p = 0.0153$ dhe 0.0004 ; < 0.0001 ; $= 0.0026$ dhe < 0.0001 ; $= 0.0283$ dhe 0.0013 – shih Figuren 30).

3.4.5 Pacientet e Trajtuar me Ekstrakte Polenesh


Edhe nga vleresimi statistikor i proporcioneve te PK u konstatua nje reduktim i intesitetit subjektiv te simptomave ne rastin e perdorimit te poleneve (35 paciente). Duke i pare vlerat e çdo simptomi klinik, ndryshim sinjifikativ u verejt te pakten ne vitin e trete ne te gjitha rastet, dhe sipas patologjise se trajtuar qe pas vitit te pare me nje vlere p prej te pakten 0.01 (shih Figurat 31-38).

Nga vleresimi statistikor i perdorimit te medikamenteve gjate ITS me polene rezultoi qe nr i pacienteve qe perdoren antihistaminike u ul lehtesisht ($p = 0.3565$), kurse nr i atyre qe perdoren bronkodilatatore dhe antileukotriene zbriti vetem pas vitit te trete te ITS (respektivisht, $p = 0.1706$ dhe $= 0.2595$ pas vitit te pare; $p = 0.0442$ dhe $= 0.0248$ pas vitit te trete). Po ashtu, nr i pacienteve te kontigjentit ne fjale u reduktua progresivisht lidhur me perdorimin e glukokortikoideve bronkiale duke arritur sinjifikance statistikore vetem pas vitit te trete te terapise me polene ($p = 0.1259$ dhe < 0.0001), kurse lidhur me glukokortikoidet orale dhe ata nazale/okulare nr i pacienteve u pakesua ndjeshem qe pas vitit te pare te ITS (respektivisht, $p < 0.0001$; $p = 0.0234$ dhe < 0.0001 – shih Figuren 39).

Konjuktiviti

Figura 7: Ecuria e intensitetit te pruritit okular ne pacientet me KA


Konjuktiviti (n=30)			
Pruriti okular	T0	t1	t3
mungon	0 0.0%	1 3.3%	9 30.0%
prezent	1 3.3%	8 26.7%	18 60.0%
mesatarisht i shprehur	13 43.3%	18 60.0%	3 10.0%
shume i shprehur	11 36.7%	3 10.0%	0
maksimalisht I shprehur	5 16.7%	0	0



Verehet ulje e intensitetit te simptomes qe ne vitin e pare te ITS

Figura 8: Ecuria e intesitetit te injektimit (eritemes) konjutive te pacientet me KA


Konjuktiviti (n=30)			
Eritema okulare	t0	t1	t3
mungon	0 0.0%	3 10.0%	12 40.0%
prezente	11 36.7%	15 50.0%	18 60.0%
mesatarisht e shprehur	9 30.0%	9 30.0%	0
shume e shprehur	9 30.0%	3 10.0%	0
maksimalisht e shpreur	1 3.3%	0	0



Verehet ulje e intesitetit te simptomes qe ne vitin e pare te ITS

Figura 9: Ecuria e intesitetit te lotimit ne pacientet me KA


Konjuktiviti (n=30)			
Lotimi	t 0	t1	t 3
mungon	8 26.7%	12 40.0%	18 60.0%
i lehte	6 20.0%	11 36.7%	12 40.0%
mesatarisht i shprehur	12 40.0%	7 23.3%	0
shume i shprehur	3 10.0%	0	0
maksimalisht i shprehur	1 3.3%	0	0



Verehet ulje e intesitetit te simptomes qe ne vitin e pare te ITS

Figura 10: Ecuria e monitorimit te nevojave farmakologjike te pacienteve me KA

Konjuktiviti n=30		
Mjekimi	Nr I Rasteve	%
Anthist_0	30	100.00
Anthist_1	30	100.00
Anthist_3	20	66.67
Kort_or_0	14	46.67
Kort_or_1	0	0.00
Kort_or_3	0	0.00
Kort_naz_0	28	93.33
Kort_naz_1	15	50.00
Kort_naz_3	1	3.33
Kort_br_0	4	13.33
Kort_br_1	1	3.33
Kort_br_3	1	3.33
Betast_0	2	6.67
Betast_1	3	10.00
Betast_3	1	3.33
A_leuk_0	7	23.33
A_leuk_1	1	3.33
A_leuk_3	0	0.00




Perdorimi i medikamenteve glukokortikoide eshte reduktuar qe ne vitin e pare, kurse i medikamenteve te tjere ne vitin e trete te imunoterapise.

Rhinitis

Figura 11: Ecuria e intensitetit te teshtitjes ne pacientet me RA


Teshtitja	Rhiniti (n=87)			Kahja e ndryshimit
	t0	t1	t3	
mungon	0 0.0%	0 0.0%	4 4.6%	↑
prezente	0.0%	3 3.4%	26 29.9%	↑
